



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
Bordi i Administrimit

Nr. 1305 Prot

Shkodër, me 15.04.2024

V E N D I M

Nr. 112 datë 15.04.2024

**" Për miratimin e përparësisë së përdorimit të fondeve grant me burim financimi nga buxheti i shtetit për pagat "**

Bazuar në ligjin e AL nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe të kërkimit shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 3germa ;ç "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", Vendimin nr 243 dt 20.04.2023, të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se vetëm për vitin 2023, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 15.04.2024 sipas email-it të ardhur nga MA

**Vendosi:**

1. Miratimin e përparësisë së përdorimit të fondeve grant me burim financimi nga buxheti i shtetit për pagat të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" bashkëngjitur email.
2. Paga do të likujdohen me burim fondet grant të buxhetit të shtetit dhe kur këto fonde të arrijnë tepriçën 0(zero)lekë atëherë likujdimi i pagave do të bëhet me burim financimi nga të ardhurat e USH-së.
3. Ngarkohet Administratori i USH për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. As. Dr. Adrian LETA





**Fwd: Pergjigje kërkeset tuaj per pagesen e pagave te punonjesve**

Idlir Bekteshi &lt;idlir.bekteshi@unishk.edu.al&gt;

mar 16/04/2024 10:56

A:Bordi Administrimit unishk &lt;bordadministrimitunishk@unishk.edu.al&gt;

Cc:Admir Uruçi &lt;admir.uruci@unishk.edu.al&gt;;Saida Bizaku &lt;saida.bizaku@unishk.edu.al&gt;

 1 allegati (94 KB)

Vendim nr.243, date 20.4.2023 Pagat ne IAL publike.pdf;

Te nderuar Anetare te Bordit te Administrimit

Lutem gjeni me poshte emailin e derguar nga Pergjegjesi i Buxhetit ne Ministrine e Arsimit ne lidhje me perdorimin e grantit te Qeverise per pagat ku ne paragrafin e fundit percaktohet qe prioriteti i burimit te pageses se pagave vendoset nga Bordi i Administrimit.

Faleminderit e pune te mbare

**From:** Florian Nurce <Florian.Nurce@arsimi.gov.al>**Sent:** Wednesday, April 3, 2024 10:59:43 am**To:** Idir Bekteshi <idlir.bekteshi@unishk.edu.al>; Admir Uruçi <admir.uruci@unishk.edu.al>**Cc:** Erzen Tola <Erzen.Tola@arsimi.gov.al>; Mirela Cami <Mirela.Cami@arsimi.gov.al>; Mirela Bimo <Mirela.Bimo@arsimi.gov.al>**Subject:** FW: Pergjigje kërkeset tuaj per pagesen e pagave te punonjesve

Përshëndetje Idir,

Uroj të jeni mirë, në përgjigje të kërkesës tuaj sqaroj së në Vendimin nr 243 dt 20.04.2023, të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se vetëm për vitin 2023, "Efekti financiar, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen, si më poshtë vijon: a) për nivelin e pagave sipas kufirit minimal (kolona 2, e lidhjes nr. 1), nga fondet e kontingjencës, të miratuar për vitin 2023; b) për çdo nivel pagë të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal (kolona 3, e lidhjes nr. 1), nga të ardhurat e veta të institucioneve publike të arsimit të lartë".

~ Në vijim janë organet kolegjiale të Universitetit "Luigj Gurakuqi", që shqyrtojnë, vlerësojnë dhe vendosin burimin e financimit të shpënzimeve të personelit.

Per me shumë në ligjin nr.80/2015 në nënim 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", përcaktohet:

- 1. Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislationin në fuqi.
- 2. Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës:
  - a) për të organizuar veprimtari të mësim-dhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtari të krijesë;
  - b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
  - c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.
- 3. **Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës:**
  - a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtari të mësimdhënies, nga veprimtari kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtari të artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislationin në fuqi;
  - b) për të përfunduar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;

- c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;
  - c) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj;
  - d) për të administruar pasuritë e luajshme dhe të paluajshme që institucionet zotëtojnë ligjrisht, në përputhje me misionin e tyre.
4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës:
- a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;
  - b) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me këtë ligj;
  - c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;
  - c) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.

Neni 47 Bordin i Administrimit Bordin i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton pëmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarevajtjen financiare dhe administrative të tij.

Neni 49 Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë

1. Bordin i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- a) **garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe pëmbushjen e misionit të tij;**
- b) **me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;**
- c) **me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;**
- c) **me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;**
- d) **vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndryshimet ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;**
- dh) **miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësie përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;**
- e) **jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;**
- e) **përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;**
- f) **është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;**
- g) **emëton dhe shkarkon administratorin e institucionit;**
- gj) **miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;**
- h) **miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.**

2. Në institucionet publike të arsimit të lartë vendimet e Bordit të Administrimit, për përcaktimin e bërë në shkronjën "gj", të pikës 1, të këtij neni, merren me jo më pak se tre pesën e votave të anëtarëve.


3. Kompetencat për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në shkronjat "b", "c", "ç", "d" dhe

"dh", të pikës 1, të këtij neni, në institucionet jopublike të arsimit të lartë, përcaktohen në statutet e tyre.

4. Funksione të tjera të Bordit të Administrimit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Ndaj sa më sipër është e drejta dhe detyrimi i Bordit të Administrimit të detajojë shumën e fondeve grant për mbulimin e shpenzimeve të personelit me burim financimi nga buxheti i shtetit, si dhe fondet nga të ardhurat. Po kështu përparësi në përdorimin e fondeve grant apo fondet nga të ardhurat vendosen dhe miratohen nga Bordi i Administrimit dhe jo nga Dega e Thesarit.

Ndaj sa më sipër likujdoni me përparësi nga fondet gant me burim financimi nga buxheti i shtetit, detyrimet ndaj personelit akademik, punonjësve, studentëve, si dhe të tretëve apo institucioneve shtetërore.



## FLORIAN NURCE

Përgjegjës Sektori | Head Of Unit

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar | Directorate of Budget and Financial Management

Ministria e Arsimit dhe Sportit | Ministry of Education and Sports

(A): Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë, Shqipëri

(E): [florian.nurce@arsimi.gov.al](mailto:florian.nurce@arsimi.gov.al) | (Ë): [eee.arsimi.gov.al](mailto:eee.arsimi.gov.al)

From: Idlir Bekteshi <idlir.bekteshi@unishk.edu.al>

Sent: Tuesday, April 2, 2024 5:44 PM

To: Florian Nurce <Florian.Nurce@arsimi.gov.al>

Subject: Kerkese per interpretim

**KUJDES:** Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

Pershendetje Z. Florian,

Lutem, nisur nga VKM nr 243 dt 20.04.2023, "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 748, DATË 11.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË

**"INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË"**, a mundemi qe per pagat e muajit mars te vitit 2024 , ti japim te gjitha nga granti dhe ne muajin ne vijim te japim nga te ardhurat edhe pjesen qe i takonte marsit?

Faleminderit e pune te mbare



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merri gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct.